



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:020342

Datë: 11.12.2018

Numri i dokumentit: 00186329

P. nr. 378/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Iirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit P. V. nga fshati N., Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/9-6 lidhur me par.1 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore –DP në Gjakovë, PP/II.nr. 505/18 të datës 28.05.2018, pas mbajtjes në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datë **03.12.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Armend Zenelaj, të dëmtuarës M. V., mbrojtësit të akuzuarit av. F. X. dhe të akuzuarit P. V., mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **P. V.**, data e lindjes... në fshatin N., Komuna e Gjakovës, i biri i P. dhe nënës M. e gjinisë C., punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, ka te kryer shkollën e mesme, i pamartuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës me numër të ID

Ë s h t ë f a j t o r:

Sepse:

- me datë **03.04.2018** rreth orës **13:30** në aksin rrugor **Qafa e Prushit** në Gjakovë pikërisht në fshatin B., Komuna e Gjakovës, duke drejtuar automjetin e tij të tipit “...” me targa të regjistrimit ..., rrezikon trafikun publik në përmasa të mëdha dhe jetën e të ndjerit P. V. nga fshati N. e E., Komuna e Gjakovës, ashtu që duke shkelur nenin 53 lidhur me nenin 355 të Ligjit për Rregullat e Trafikut Rrugor nr. 05/L-088, dhe vë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë, nga pakujdesia, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se më një veprim të tillë do të vije deri te pasoja e ndaluar, lehtë ka marrë se gjerë te ajo nuk do të vjen apo në momentin e duhur do t’i shmanget, dhe pasoja është shkaktuar. Në atë mënyrë që me t arritur në fshatin B., Komuna e Gjakovës, nuk ja përshatë shpejtësinë e lëvizjes automjetit të tij sipas kushteve dhe rrethanave të rrugës ku rrugë ishte me kthesa, humb kontrollin mbi automjetin e tij, del jashtë rruge në krahun e majtë të lëvizjes së tij dhe me pjesën anësore të krahut të djathtë përplasat për muri të betonit – kanalit të ujit, ku edhe rrotullohet, me ç’rast pasagjeret e tij P. V. pëson lëndime të rënda trupore ku për ndihmë mjekësore dërgohet në QKUK në Prishtinë dhe me datë 03.04.2018 ndërron jetë në repartin e Intensives në QKUK në Prishtinë me 11.04.2018,

ndërsa M. V. pëson lëndime trupore të konstatuara në raportin e Spitalit Rajonal “....” në Gjakovë të datës 03.04.2018.

- me çka ka kryer veprë penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 9/6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Gjykata konform dispozitave të nenit 77 dhe 78 par.1 nën par.1.1 të KPRK-së , të akuzuarin P. V. e :

LIRON NGA DËNIMI

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrën e mjeteve buxhetore të Gjykatës .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë –Departamenti i Përgjithshëm , ka ngritë aktakuzën PP/II. Nr. 505/2018 të dt.28.05.2018, ndaj të akuzuarin P. V. nga fshati N, Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/9-6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 03.12.2018, prokurori i shtetit Armend Zenelaj lexoi aktakuzën PP/II. Nr. 505/2018 të dt.28.05.2018 me ç ‘rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari P. V., në shqyrtimin fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe më parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtoi se deri te ky aksident ka ardhur nga pakujdesia në të cilën ka vdekur prindi im – babai P. V., po ashtu edhe unë vetë së bashku me nënën time kemi pësuar lëndime të lehta trupore, shoi se me pranimin e fajësisë jam tejet i penduar me qenë se ky aksident më ka goditur psikikisht, pasi që kam humbur anëtarin e familjes konkretisht babanë, premtoj se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm, andaj i propozoj gjykatës që të marrë rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehu në gjykatë, gjendjen e dobët ekonomike si mbajtës i vetëm i familjes dhe i vetmi person që kujdeset për nënën e tij e cila është në gjendje të rënë shëndetësore e sidomos nga fakti për humbjen e anëtarit të ngushtë të familjes, si dhe faktin se është hera e parë që kam ra ndesh me ligjin, të më shqiptojë dënim më të butë.

E dëmtuara M. V. , në shqyrtimin fillestar deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe nuk kërkon kompensim dëmi me qenë se edhe vetë ka pësuar i akuzuari ka pësuar lëndime të lehta trupore dhe se kjo veprë nuk është kryer me dashje dhe po ashtu deklaroi se këtu i akuzuari është i vetmi anëtar që kujdeset për mua.

Prokurori i shtetit Armend Zenelaj deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit P. V., pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës, andaj i propozoi gjykatës që këtu i akuzuari P. V. të shpallet fajtor dhe të dënohet në bazë të ligjit e po ashtu i propozoi gjykatës që i njëjti të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Pasi gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë për veprën penale që i vihet në barrë dhe është bindur se pranimin e ka bërë në baza vullnetare duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban Aktakuza, si kallëzimi penal ER-3004-092-2018 të datës 03.04.2018, Raporti i policisë mbi vendshiqimin e aksidentit me numër të lëndës ER-3004-092-2018 të datës 03.04.2018, Procesverbalin mbi intervistimin e të dyshuarit me numër ER-3004-092-2018 të datës 04.04.2018, Raportet e Repartit të Emergjencës me nr. rendor,, të dt. 03.04.2018 të Spitalit Rajonal “....” në Gjakovë, Akt ekspertimi mjeko-ligjor me numër të referencës e datës, Fletëvdekje me epikrizë me numër të amzës dhe vërtetimi për vdekjen e dt. , Ekspertiza e aksidentit të komunikacionit e datës, Foto-dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 par.1 të KPP-së ashtu që shqyrtimin gjyqësor e ka vazhduar pa fjalën përfundimtare të palëve.

Gjykata konform dispozitave të nenit 77 dhe 78 par.1 pika 1.1 të KPRK-së, të akuzuarin P. V. e ka shpallur fajtor por e ka liruar nga dënimi për shkak se vepra penale është kryer nga pakujdesia dhe pasojat e veprës penale e kanë goditur rëndë të akuzuarin sa që dënimi është i panevojshëm për realizimin e qëllimit të tij, pasi që nga kryerja e kësaj vepre penale nga pakujdesia ka vdekur babai i të akuzuarit ndërsa vetë i akuzuari bashkë me nënën e tij kanë pësuar lëndime të lehta trupore, andaj shqiptimi i dënimit është i panevojshëm por i njëjti është shpallur fajtor për veprën e kryer.

Vendimi që shpenzimet e procedurës penale të bien ne barrën e mjeteve buxhetore, gjykata e morri ne mbështetje te nenit 453/4 te KPP-së, pasi qe i akuzuari është shfrytëzues i ndihmave sociale e detyrimi qe ti paguajnë shpenzimet procedurale do të rrezikonte gjendjen materiale te akuzuarit ose të personave që ajo detyrohet ti mbështes materialisht.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr. 378/18 më datë 03.12.2018**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**G j y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, ne afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes se tij ne dorëzim ,Gjykatës se Apelit ne Prishtinë. Ankesa ne kopje te mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate .